

VENDIM
Nr. 3, datë 28.1.2026

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 12, DATË 3.3.2023, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME LUSHNJË SHA”**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958); si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e Licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 28.1.2026, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit, për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 12, datë 3.3.2023, “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë sh.a.”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë sh.a. me shkresën nr. 61 prot. datë 16.1.2026, me lëndë “Dërgim dokumentacioni për rinovim licence, për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik të shoqërisë të shoqëruar me dokumentacionin, sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, të ndryshuar.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë sh.a. për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit, të ndryshuar.

3. KKRR-ja ka licencuar Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë sh.a. me vendimin nr. 12, datë 3.3.2023, “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë sh.a., me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe të shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtues teknik i shoqërisë z. Ferdinand Gjermani, inxhinier mekanik është diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Elektrike, dega Mekanikë në vitin 1986 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958, mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë, të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe të Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë sh.a. është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Pika 2 b) e vendimit të KKRR-së nr. 12, datë 3.3.2023, “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë sh.a.”, ndryshojnë, si më poshtë:

“b) Drejtues teknik: z. Ferdinand Gjermeni.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gerta Lubonja